



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. Ilir Konushevi, Nr.8, 10000 Prishtinë
info@pak-ks.org – www.pak-ks.org

E Mërkurë , 1 qershor 2011

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Ndërmarrja e Re “Betonjerka SH.P.K.’ tërhiqet nga Vala 50 e privatizimit

PRISHTINË – Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka tërheqë sot nga Vala e 50-të e Privatizimit, Ndërmarrjen e Re “Betonjerka SH.P.K”.

Kjo ndërmarrje ishte paraparë të privatizohet me datë 15 qershor përmes Valës 50, bashkë me 14 ndërmarrje të reja.

Më poshtë mund të gjeni listën e plotë të 12 ndërmarrjeve shoqërore nga të cilat janë krijuar 14 ndërmarrje të reja që do të jenë në dispozicion në Valën 50:

Ndërmarrja e Re Ekonomia Pyjore Lipjan SH.P.K. - me rreth 50 ari 71 m² (50.71 m²) tokë bujqësore në të cilën gjendet dhe një ndërtesë administrative me një sip. 133 m² e cila është në gjendje të keqe. Ndër. e Re shtrihet në zonën kadastrale Lipjan në një largësi nga kryeqendra-Prishtina prej afro 16 km.

Ndërmarrja e Re Tokë Bujqësore Jahoc 3 SH.P.K. - gjendet në zonën kadastrale Jahoc (të njohur gjithashtu edhe si Çabrat) të Komunës së Gjakovës. Kjo Ndër. e Re përbëhet kryesisht nga toka bujqësore prej përafërsisht 491192 m² (49 ha 11 ari dhe 92m²). Në këtë tender nuk është përfshirë asnjë ndërtesë, bagëti apo asete tjera të lëvizshme. Ky tender i ofron investitorit potencial mundësinë e zhvillimit të mëtejshëm të agrobiznesit në rajonin e Gjakovës.

Ndërmarrja e KBK Strezoci Ndërtesa e Administratës dhe Oborri SH.P.K. - Kjo ofertë do të sigurojë një mundësi të shkëlqyer për të blerë një ngastër toke në madhësi prej përafërsisht 2250 m², së bashku me ndërtesën administrative me rreth 80 m² të përshtatshme si pikë për grumbullimin e produkteve të ndryshme bujqësore (qumështi, kërpudhat ...) dhe vend për shitjen e sendeve të ndryshme bujqësore/pajisje, të vendosura në fshatin Strezovc/ Strezovcë 12 km nga qyteti i Kamenicës.

Ndërmarrja e Re Stacionit të Veterinarisë Mitrovicë SH.P.K. - në Mitrovicë SH.P.K. gjendet në Komunën e Mitrovicës dhe përbëhet nga prona e përkthuar sipas parcelës 2908-2 dhe certifikatës poseduese nr 6341 dhe ka sipërfaqe të përgjithshme prej 2419 m².

Për më shumë informata ju lutemi kontaktoni Znj. Arta Gosalci në arta.gosalci@pak-ks.org apo në 038 500 400 lokali 1110

Ne kuadër të kësaj hapësire të përgjithshme ndodhet edhe ndërtesa me rreth 200 m² e cila nuk është e përshkruar në kopje të planit .Kjo Ndërmarrja e Re do të ri-tenderohet.

Ndërmarrja e Re Kopiliqi i poshtem 2 SH.P.K. do të ketë një sipërfaqe prej përafërsisht 105,46.78 ha tokë bujqësore dhe përfshinë vetëm 8 parcela të përshkruara në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL-72015028-100, Zona kadastrale Kopiliqi i poshtem. Asnjë ndërtesë e NSH nuk do të transferohet në këtë Ndërmarrje të Re.

Ndërmarrja e Re Shala SH.P.K. - përfshinë një sipërfaqe të përafërt prej 26940m², sipas Listës Poseduese nr. 3361 zona kadastrale Mitrovicë, Komuna e Mitrovicës. Ka objekte që transferohen në Ndërmarrjen e Re me një sipërfaqe prej përafërsisht 880m². Vërejtje: Duhet të merret parasysh se do të kemi ca ndryshime pasi të bëhen matjet në teren ,sa i përket sipërfaqes së tokës dhe ndërtesave që do të transferohen në Nder. e Re Ndërmarrja e Re tani shfrytëzohet/okupuar nga EULEX. Aktiviteti kryesorë i saj ka qenë shitja e materialit ndërtimorë me shumicë dhe pakicë.

Ndërmarrja e Re Dukagjiniremont - Depoja SH.P.K. - përbën një mundësi të mirë investimi në objektin, e përdorur si shitore, me sipërfaqe rreth 472m² e cila ndodhet në katin përdhese të një objekti banesor në ngastrën kadastrale nr. 240/2, FP 5774 Zona Kadastrale Pejë, afër stacionit të autobusëve në Pejë, Kosovë.”

Ndërmarrja e Re Ereniku Bodrumi i Verës SH.P.K. - përfshin kompleksin e Bodrumit të Verës, që përfshin sipërfaqen e përgjithshme të tokës rreth 31034m², të regjistruar në Ngastrën Kadastrale nr 510, FP.319, ZK Qerim në Komuna Gjakovë, ndërtesat e pajisura të cilat zënë rreth 4550m² sipërfaqe toke, dhe stoqet prej rreth 2,000,000 litra verë llojesh dhe moshash të ndryshme, fundërrinë për distilim si dhe destilat të verës.

Ndërmarrja e Re Hotel Onix Banja e Pejës dhe Ilixhe SH.P.K. - ofron mundësi të mirë investimi në blerjen e ish-Hotel dhe Ilixhe në “Banjë të Pejës”, Komuna Istog në një sipërfaqe rreth 26 ha dhe më shumë se 38.000 m² sipërfaqe të ndërtesave. Ndërmarrja ka të drejtën e përdorimit të burimit të ujit i cili ka veçori shëruese i cili është i vetmi në Kosovë dhe një ndër të paktit në rajon.

Ndërmarrja e Re Rilindja Zona Industriale SH.P.K. - i ofron blerësve potencial mundësi për blerjen e tokës me një sipërfaqe prej përafërsisht 12,331 m² (1 ha 23 ari 31 m²) dhe dy ndërtesa komerciale me sipërfaqe totale prej përafërsisht 2,105 m², që gjendet në Zonën Industriale të Prishtinës.

Ndërmarrja e Re Ratar Ajvali SH.P.K. - ofron tokë bujqësore me sipërfaqe përafërsisht 527,135 m² (52 ha 71 are 35 m²) në një pjesë mjaft atraktive në zonën kadastrale Ajvali. Prodhimtaria e produkteve bujqësore mund të rritet dukshëm me investime përkatëse.

Ndërmarrja e Re Ratar Llapllasellë SH.P.K. - ofron tokë bujqësore me sipërfaqe përafërsisht 62,680 m² (6 ha 26 are 80 m²) në një pjesë mjaft atraktive në zonën

Për më shumë informata ju lutemi kontaktoni Znj. Arta Gosalci në arta.gosalci@pak-ks.org apo në 038 500 400 lokali 1110

kadastrale Llapllasellë. Prodhimtaria e produkteve bujqësore mund te rritet dukshëm me investime përkatëse.

Ndërmarrja e Re Liria “Salloni i Mobileve” SH.P.K. - përfshin kompleksin komercial/ ndërtesën që përmban bodrumin me rreth 900 m², katin përdhes me rreth 950 m² dhe nën kulmin me rreth 50 m² (B+P+nk), dhe ndodhet në rrugën “Zahir Pajaziti” p.n në zonën primare të qytetit të Prizrenit.

Sipërfaqet e prezantuara si më lartë janë sipas matjeve interne dhe jo zyrtare.

Më 31/03/2011 ZKK-Prizren ka lëshuar Kopjen e Planit të azhurnuar sipas matjeve të fundit ku është cekur sipërfaqja e jashtme/gabariti i objektit të sallonit të mobileve të jetë 1016 m². **Megjithatë, përfundimisht sipërfaqja e saktë do të dihet pas bartjes së pronës në emër të NSH-së nga ana e drejtorive përkatëse të KK Prizren.**

Kërkesa e fundit e ZR AKP-Prizren për bartje të pronës sipas azhurnimeve të fundit nga ZKK Prizren, në Drejtorinë për Pronësi KK Prizren është dorëzuar me datë 05/04/2011. Aktualisht kompleksi komercial/salloni i mobileve është i dhënë me qira palëve të treta.

Ndërmarrja e Re Liria “Mini Shtëpia e Mallrave”-Terzimahallë SH.P.K. -

kompleksi komercial/mini shtëpia e mallrave për tu bartur në Ndërmarrjen e Re sipas fletës poseduese dhe kopjes së planit të lëshuar nga ZKK-Prizren përshin një sipërfaqe totale të gabaritit prej 281m². Kompleksi komercial/mini shtëpia e mallrave përmban ndërtesën dykatëshe (B+P+1) që përfshin katin përdhes me sipërfaqe rreth 225 m² (dy shitore dhe një depo), katin e parë me sipërfaqe rreth 200 m² dhe bodrumi me sipërfaqe rreth 30 m². Sipërfaqet e prezantuara si më lartë janë sipas matjeve interne dhe jo zyrtare. Kompleksi komercial/mini shtëpia e mallrave ndodhet në rrugën “I.J.Kumanova” p.n. në Terzimahallë, zonë primare e qytetit të Prizrenit.

Aktualisht dy shitore që ndodhen në përdhes të kompleksit komercial/mini shtëpia e mallrave janë të dhënë me qira palëve të treta.

Vërejtje: ndërtesa për banim trekatëshe e cila ndodhet përmbi objektin mini shtëpia e mallrave nuk është lëndë e këtij tenderi.

FUND